VENDIM
Nr. 22, datë 18.1.2017

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME, NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT, PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE QË RRJEDHIN NGA ZBATIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE PËR VIKTIMAT E NGJARJES SË 21 JANARIT 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, i shtohet fondi prej 160 011 479 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, akordohet për Gardën e Republikës së Shqipërisë, për shlyerjen e detyrimeve sipas vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

Vendimi	Gjykata	Vlera e detyrimit
Vendimi nr. 2716, datë 28.7.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	42 021 626 lekë
Vendimi nr. 6189, datë 21.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	23 619 896 lekë
Vendimi nr. 6337, datë 28.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	18 836 416 lekë
Vendimi nr. 6300, datë 27.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë	75 533 541 lekë
		Totali 160 011 479 lekë